

# Halit Xh. Elshani

\* \* \* \* \*



*Kosova është Shqipëri*

# DITARI I NJË LUFTËTARI TË UÇK-së

2017

# **DITARI I NJË LUFTËTARI TË UÇK-së**

© Halit Xh. Elshani 2017

\* \* \* \* \*

Ditari  
**Gani Shala**

Autor  
**Halit Xh. Elshani**

Recensent  
**Bedri Tahiri**

Redaktor  
**Muhamet Hoxhaj**

Kopertina dhe pregaditja për botim  
*Muhamet Hoxhaj*

# Halit Xh. Elshani



Botues  
“ ” 2017



*Në vend të prologut*

Ditari është njëra prej formave më delikate e të shkruarit, një punë në vetën e parë që nuk mbaron kurrë! As nuk mund ta ndërrosh as ta modifikosh! Është origjinal. Ky Ditar është edhe një Aktpadi e gatshme që është dashur ta shfrytëzojnë: organet e ndjekjës së Eulex-it, Prokuroria e shtetit, Tribunali i Hagës, Organizatat për të Drejtat dhe Lirit e Njeriut, etj. Ditari mund të jetë shkruar në shumë gjini letrare. Në roman, kronikë, dramë, komedi, poemë, skenar etj.

Posaqërisht ky që ka të bëj me luftën, me sakrificat dhe egzistencën, mbi të gjitha mbijetesën

***Ja vdekje Ja Liri!***

Kjo vlen për popujt e robëruar nga barbaria e atyre që i mbajnë të robëruar popujt, posaqërisht komunitetet e ndara nga shteti amë që dëshirojnë të çlirohen njëherë e përgjithmonë. Të rralla janë, shumë të rralla Ditarët e luftës, janë të shkruara më gjakun, me pendën e ngjyer në gjakun e derdhur nga plagët, nga përdorimi çnjerëzor i dhunës sepse ajo shkruhet në kushte të jashtëzakonshme!

Ajo grumbullohet në zemër, ruhet në mendje deri në momentin e të shkruarit. Moment kur fillojnë të pushojnë dhembjet në mënyrë që duart mos të dridhen! Kur e shkruan duhet të mendosh si ta ruash dhe ku! Për fatin e tij dhe a do arrijnë të çlirohet edhe ai për ta parë dhe lexuar të tjerët! Pra nëpër këto etapa kaloj ky ditar dhe ja sot falë përkushtimit, fatit të Gani Shalës, sot është në duar tona. Duke qenë kësaj falë sygjërimeve të miqve, lexuesve, vendosa që ta botoj në këtë formë.

*Shpresoj të jetë një shembull autokton*

**Autori**



**Pamje nga hyrja e burgut – Dubravë**



**Kulla e vëzhgimit(Karaulla) e burgut të Dubravës**

Dhe, para së gjithash, ruhuni nga mallkimi i historisë dhe mos e harroni atë kur të jepni mendimin tuaj!”

*Hasan Prishtina*

### **Masakra e Dubravës është një brengë që don zbardhjen sa më pare të këtij krimi të paparë në historinë e njerëzimit**

Shtëpia Ndëshkimore Korrektuese - Istog (Burgu i Dubravës) shtrihet në pjesën veri lindore të kësaj komune. Kishte filluar së ndërtuari më 1979, me një vendim të KSAK për t’u lëshue në funksion më 1986.

Kapaciteti 1200 shtretër, 148 hektar, 12 h pavijone, 6 ha pavijone banimi. Kjo shtëpi ishte një shpresë për shumë të burgosur që dergjeshin në burgjet ish-jugosllave. Ngjarja që kishte ndodhë në këto burgje i vetëdijësoj udhëheqësit tanë dhe bënë një punë shumë të qëlluar.

Masakra e Dubravës është një brengë e pashlyer në kujtimet e kombit shqiptar. Është një ndërgjegje e thyer në analët e historiografisë ndërkombëtare.

Është padyshim një shkelje e rëndë e të drejtave dhe lirive të njeriut të sanksionuar nga Konventa Ndërkombëtare.

Lidhur më këtë po shpalosim Ditarin, apo më mirë me thënë dramën e një të mbijetuarit se çka dhe në çfarë kushtesh tmerrri, padrejtësie, gjenocidale e kryer ndaj të burgosurëve në kazamatet ish-jugosllave në kundërshtim me normat dhe etikën e njerzimit perendimor, posaqërisht në Dubravë që ka mundur të shënojë në Ditarin e vet për të zbardhë sado pak krimet e bëra nga barbaria serbe.

**Gani Sylë Shala** është djali i madh i *Sylë (Osman) Shalës* nga Ruhoti, KK-Pejë. Rruga e tij dhe bashkangjitja në radhët e UÇK-së, është sa e lavdishme aq edhe shembull emblematic i një qëndrese titanike në luftë për liri, është një histori e vuajtjeve dhe gjenocidit që kanë bërë shërbimet shtetërore militare, paramilitare serbe ndaj kombit shqiptar në periudha të ndryshme të historisë, mbi 100-vjeçare nën thundrën okupuse serbe!

Lufta e fundit është strumbullar i një gjenocidi me përmasa shkatërruese në masë ndaj një populli-kombi autokton të pa mbrojtur.

Kjo rezistencë-luftë ka hyrë në analet e historisë së luftërave botërore si guerila më e sukseshme për çlirim dhe për mbrojtjen nga shkatërrimi i qenjes njerëzore shqiptare nga urrejtjet patologjike, robëria qindvjeqare.

### **”Ushtria Çlirimtare e Kosovës nuk ka krye krime.**

Ajo ka zhvilluar luftë për mbrojtjen e trojeve etnike shqiptare dhe çdo tendencë për njollosjen e kësaj lufte është krim. Është krim edhe ndaj atyre në Hagë, në burgjet e Kosovës, Serbisë që gjenden padrejtësisht dhe natyrisht përkushtimi i të gjithë neve është që të lirohën sa më shpejt që është e mundur.

Kjo do ishte drejtësi.

Nuk mund të barazohet viktima më agresuesin e çarqeve ndërkombetare në krye më prokurorin Salustro. Kësisoj u mundue edhe Karla Del Ponte.

Këtë e ka vertetue edhe gjyqi i Hagës. Eulex,-i duhet të vret mendjen, ta bëjë të çartë se kush ishte agresori dhe kush viktima!





**Mejremi, Nëna e Ganiut dhe Shemsiut në foto, tani që të dy të ndjerë!**

## **Vdekja e Sylë Shalës!**

Syla kishte ndërruar jetë shumë herët, më 4 tetor 1984 në spitalin e Beogradit, kur ishte vetëm 54-vjeç.

Mungesa e tij për familjen ishte mjaft e vështirë.

Në njërën anë ishte lufta për egzistencë, në anën tjetër ishte dëshira dhe përpjekja për arsimimin e fëmijëve.

Mejremi, nëna e Ganiut e kishte përjetuar rëndë humbjen e kryefamiljarit, burrin e sidomos burgosjen e Ganiut, ajo vdiq me 16 mars 2007.

Vëllau i Ganiut, Shemsia, ka ndërruar jetë në moshën 51 vjeçare, me 25 janar 2008.

## Burgosja e Komandant Gani Sylë Shalës

*Lufta për liri dhe mbijetesë ishte një shembull titanik që  
bënë UÇK-ja në Kosovë dhe në të gjitha trojet etnike  
shqiptare.*

Për shkak të aktiviteteve në UÇK si komandant togu i emëruar nga **Gjeneral Ramush Haradinaj** për anën e lugut të Drinit, pushtetarët e atëhershëm, shërbimet sekrete, mafia, policia e kishin kërkuar shumë here! Për t'i ikur burgosjes ai ishte lajmëruar në emër të vëllaut, Shemsiut.

Pra gjatë leximit do të mësohet se Ganiu është paraqitur në emër të Shemsiut dhe gjatë tërë vuajtjeve ka qëndruar me emrin e vëllait për t'i përballuar më lehtë gjoja represaljet barbare, çnjerëzore të aparatit shtetëror të shërbimit të Millosheviqit, por kjo fatkeqësisht ia kishte rënduar akoma më shumë vuajtjet, rrahjet, plagosjet, kryqëzimin, bartjen e kryqit 5 kg. në shpinë, represaljet për marrjen e veshkës etj.

Kalvari i këtyre vuajtjeve është një dramë e vërtetë se çfarë mund të bëjë njeriu ndaj njeriut!

Të kujtojmë Hopsi-n  
”Njeriu ndaj njeriut është ujë“



”Edhe sikur të na vrasin të gjithëve këtu, Kosova ka  
djemë e vajza që do t’i dalin zot Kosovës”

**Mr.prof.Ukshin Hoti**

## **Fjalët e Mr.Prof. Ukshin Hotit ishin udhërrëfyese për të gjithë të burgosurit**

Fjalët e Prof.Ukshin Hotit kanë qenë udhërrëfyese për qëndrim dinjitoz në burgun e Dubravës, por fatkeqësisht ai nuk e mbijetoi, sepse e muarrën dy veta kur e kishte kryer afatin e dënimit, kur duhej të shkoj në shtëpi. Kjo ditë, ishte jo ditë pune, e dielë. Marrja e tij ishte akt joligjor dhe me prapavijë vrastare!

Doli me një thes në shpinë i përcjellur nga dy agjent shpirtshitur dhe të pa besë! Janë dëgjuar të shtëna dhe nuk dihet sot e kësaj dite asgjë për fatin e tij!

Kjo ishte dhe është dhembje për familjen dhe për të gjithë shqiptarët.

Ai, më shtrëngoij për faqe dhe më tha:

***”Edhe sikur të na vrasin të gjithëve këtu, Kosova ka djemë e vajza që do t’i dalin zot Kosovës”.***

Populli që kërkon liri është më i fortë se krisma e gjithë topave të Serbisë e Jugosllavisë! Veç vdekja mund të ndaj nga Pavarësia e Kosovës.

Ai thoshte problemi i gjithë shqiptarisë është si rreze dielli që del në mengjes herët mbi fijen e një bari që vesa e mëngjesit bie mbi fijen e barit ku rrezet e diellit e shkrijnë, kështu do të shkoj edhe problemi i shqiptarisë.

Kur shqiptarët do të bashkohen të gjitha trojet në një të vetme, rrezet e diellit nuk do të shkrijnë më, jo një vesë bari, por në gjithë trojet etnike shqiptare”.



“Në ballë të këtij populli dhe te këmbët e këtij populli,  
flijimi dhe vdekja për realizimin e aspiratave të tij, do të  
vijjnë si përjetimi më i bukur e më fisnik në gjithë jetën  
dhe s’do të këtë forcë që do të na ndalë në rrugën tonë të  
ndritshme”

**Jusuf Gërvalla**

## **SHPALOSJA E DITARIT**

Të falësh mëkatarët është shumë humane dhe krijon ndjenjë çliruese, por ti harrosh ata që deri dje kanë qenë vegla të pushtuesit është papërgjegjësi historike dhe veprim primitiv e jo qytetërues.

**Ismajl Rugova**



## **A DUHET TË HYJ NË LIBRIN E GENISIT?**

Këtu çdo gjë është origjinale, sepse çdo gjë flitet nga zemra dhe shpirti i njerëzve që e kanë mbijetuar këtë golgotë.

Këtu nuk ka komente, këtu ka vetëm argumente.

**Bedri Halimi**

Njeriu që përjetoi burgosje, transferim në të gjitha burgjet famkeqe ish jugosllave serbe ku brenda dy vjete bartej si me qenë kafsh: prej një burgu në burg tjetër: Gjakovës, Pejës, Istogut, Dubravës, Lipjan, Pozharevcit, Nishit Leskocit, Beogradit, Novi Sadit, Zajeqar, Kralevë, Prokuplë, Prishtinë, Dubravë dhe anasjelltas deri në ditën e liritimit nga burgu i Dubravës.

Këto data që do vijnë janë drama e njerëzimit që duhetë dihen dhe të mbahen mend, brez pas brezi, se si një pushtet historikisht gjenocidal ka veprue në sy të Ballkanit, Evropës dhe më gjerë, ndaj një populli të pambrojtur liridashës.

"Asgjë tjetër nuk mund ta frymëzoj kaq shumë njeriun, se sa vetëdijësimi për gjendjen e tij të pashpresë".  
**Albert Kamy (Camus - 1913-1960)**

## Udhëtimi për Shqipëri 23 prill 1998

Isha në Gllogjan, më thanë po të thërret Shpend Mala.  
Kur shkova te Shpendi, më tha Gani sonte jam për rrugë  
për Shqipëri. Ani Shpend, edhe unë me ty.

Kur u bëm rresht, vërejtëm se cilat fshatra kishin ardhë:

Fshati Naberxhan,

Fshati Istogu i Ultë,

Fshati Jabllanicë e Vogël,

Fshati Ruhot,

Fshati Zabllaq,

Fshati Saradrani dhe

Fshati Lubizhdë

Nga këto fshatra ishin tubuar afro 90 veta. Kah ora 21 e  
mbrëmjes u nisëm. Kur mbërrijtem në mëngjes në Junik,  
na grumbulluan, na sistemuan në Xhami. Dola dhe  
shkova te komandanti i Junikut, përkatësisht te Musë  
Krasniqi. Ani baca Musë?!

-Ai në mes tjerash më njoftoj; "Shalë mbrëm në kufi janë  
vlarë 110 veta, Bekim Berisha ka qenë me ta. Dolëm me  
Musën në oborr.

Çka me pa? Vinin ca të varruar, e të përgjakur lajmërojnë  
shifra të ndryshme të të rënëve, diku njëqindë e diku 300  
qindë! U bë panik, lemëri nga plagët nga dhëmbjet.

Doli Lum Haxhiu prej Junikut, lajmëron diplomacinë e  
jashtme e ata vendor. Kërkuam ndihmë nga Junikasit nga  
Gllogjani. Ndihma nuk vonoj dhe ju ndihmuem aq sa  
patëm mundësi.

Hero nuk janë vetëm ata që vdesin! Ata e kanë krye amanetin, por mos t'i harrojmë të gjallët sepse historia ka për të na gjykuar pamëshirëshëm!

**Halit Elshani**

## Udhëtimi nëpër labirintin e vdekjes

U nisëm për në Gjocaj dhe u takuam me Bekim Berishën, i cili me njoftoi se tetë janë vrarë dhe një është i humbur.

U kthëm në Junik. Aty më urdhëruen që të kaloja tjetrës rrugë-pikë, nisesha për “trekëndshin”. Ani baca Musë i thash. I rreshtova vullnetarët e furnizimit me armë dhe u nisëm për Shqipëri.

Qarkullonin informata që të gjithëve do të na vrasin.

Ishte përforcuar shumë kufiri nga ushtria serbe. Epilogu i grupit para nesh ishte shumë katastrofal.

Siç thash më lartë kishte të vrarë e të plagosur e të humbur. U detyruam të kthehemi prapa. I komandova që të niseshin nga prapa, disa qanin prej gëzimi. Kur erdhëm në Glllogjan na doli Ramushi përpara.

*Me pyeti: **Shalë çka u bë?***

Shok komandant unë nënën nuk e kam pasur në Junik që të më furnizoj me armë, s’ka pasur armë në Junik!

Shalë qomi për Çollapek se të tjerët po i përcjellim për Drenicë. I qova sipas urdhërit. Por, unë u ktheva pas prej Qollopekut në Glllogjan dhe kam bë roje.

- *Pas shumë vjetësh, pas lufte është gjetur i humbur! Ai ka qenë **Imer Sadri Osmanaj** nga Prekalla dhe është rivarros me 2005 në vendlindjen e tij.*

## Në qershor 1998

Udhëtova nga Kaqaniku për Junik-Gjocaj dhe dolëm në Shqipëri. Gjatë rrugës ra në minë dhe u plagos Shpend Mala, ndërsa kali u bë katër copash.

*Me 11 qershor* me dhjetë veta kaluam kufirin nëpërmes Kosharës e Rrasës së Zogut.

## Më tre korrik 1998

Në Hereq u takova me Musë Çetën nga Trubuhoci. Ai ishte nisur për Shqipëri, ndërsa unë isha duke u kthyer, mbërrina në Glllogjan, kërkova të shkoja për Ruhot. Kur u nisa rrugës u takova me disa djemë dhe biseduam për luftën që ishte zhvilluar në Loxhë.

Kur arrita në Lumbardh u takova me Sali Çekun.

E pyeta për Loxhë.

Salihi me tha: "Gani m'erdhi mirë që morrët pjesë ju Ruhoti dhe Peja në luftën e Loxhës".

Sali i thash: Jo vetëm Ruhoti por kanë marrë pjesë edhe Studenica, Zabllaqi, Ozdrimi i Pejës, disa nga Kapeshnica e Pejës.

Salihi ma kthej: "Atë ditë kanë qenë mbi 1500 veta". Salihi më tha Gani duhesh me u kthye përsëri për Glllogjan, me qëllim që unë t'ju prijsa përsëri për Shqipëri. Në rregull! U kthyem dhe pas pak arritëm në Glllogjan.

Ju afrova Ramushit e i thash: "*Ramush nuk kam asnjë pare për duhan*" Ramushi më dha para.



Lufta i krijon herojt e vet. Ata duhet të përkujtohen sepse nuk vdesin kurrë sikurse edhe për të gjallët! Ky është obligim dhe ndera e kombit.

**Halit Elshani**

## Një automatik shkoj për dy gomarë!

Kur u ktheva nga Ramushi, e pash një grup në rrugë, ju drejtova dhe ju thash a mundem djema të ju ndihmoj diçka?

-Jemi nisur thanë për Shqipëri.

Sa veta jeni ju thash?

Jemi 18 veta.

Shkova përsëri te Ramushi, ai ishte shumë i zënë, ju afrova Shkëlzenit, vllait të Ramushit (tash Hero).

Ai m'i dha 1000 marka dhe më tha: "shiko në ke mundësi t'i grumbullosh rreth 50 veta"!

Ani Shkëlzen i thash.

Ma dha një letër.

Në ora 21:00 në mbrëmje të datës 5 korrik 1998 u nisëm për rrugë.

Kur arritëm në Junik.

Musë Krasniqi dhe Gani Shehu më këshilluen: Gani ruju dhe shko rrugës në drejtim të pikës për "trekëndësh"!

Gjithashtu më pyetën prej nga janë këta shokë?

Unë thash nga Doganajt e Kaqanikut.

Kur ju afruam "trekëndëshit" gdhiu dita.

Mezi e kaluam kufirin, sepse ishte i minuar dhe morrëm edhe ca plagë të vogla nga shpërthimi i minave në kufi.

Pasi kaluem na dhanë ndihmë disa barinjë të Shqipërisë.

Kur mbrijtëm afër Tropojës m'u desht të bleja dy gomarë, sepse dy të lënduarit ishin lodhë bukur shumë.

Parat nuk m'i morrën, m'u dasht tua jepja automatikun për gomarë dhe kësisojt arritëm në Tropojë...

## Korrik 1998

Në korrik 1998 u takova përsëri me Musë Çetën 60- vjeç. U printe fshatit Trubuhovc me 20 vullnetar. Unë ju bashkangjita këtij grupi dhe shkova te Qorri (Xhabit Zharku). Ai ka qenë i ngarkuar për shpërndarjen e armëve. Ia tregova rastin e automatikut, ai më tha nuk është problem për atë armë. Armët që furnizoheshim ishin në Tropoj në kullën e Berishajve.

E thirra dhe më njoftoi se ka mbetur me shumë ushtarë.

Pse ju ra Juniku?

Qante si fëmija, prej gazepit që smundeshim të ktheheshmi pas..

Më 10 korrik 1998 ramë në Ujëz mbi 1000 ushtar. Kush do të na printe? Duel Sali Veseli e na priu. Dikush thoshte janë mbi 500 veta, dikush 400.... Në Gjocaj ka ora gjashtë e mëngjesit na hetuen na sulmuen shkiet.

Arritëm në Junik. Aty u takova me Bekim Berishën dhe Bedri Shalën. Ah Gani bre Juniku ra! Menjëherë jemi rreshtue në roje, unë Ganiu, Musa, Shaipi dhe Luan Çeta.

Kjo roje në Berishë ishte e gjatë afro një muaj. Takohemi me Bekimin dhe i thash qe një muaj në Berishë nuk vjen kush më na ndrrue!

Bekim më tha:”Gani shumë pak jemi ushtarë, kanë ikur, i kanë lënë pikat! Sot është dhjetë gushti, në mbrëmje e lajmruem Junikun.

Në ora tre të ditës vritet Bedria dhe Bekim Berisha.

Musa më tha:”Gani lerëni pikat, ngjituni në mal. Mbi 300 veta rob e fëmijë mbrijtëm t’i terheqim shëndosh e mirë.

## Rënia në pritë afër Erenikut

*12 gusht, 1998*

Me 12 gusht, 1998 u ndamë nga grupi, i lamë armët të Kangres Memija, nisemi për “Trekëndësh” vetëm unë e Musa. Kur mbrëmë të kufiri luteshim Zotin që të na ndihmonte që ta kalonim pa lëndime. E qoj zoti një shi me murmurimë, breshër e humbëm edhe rrugën. Vallë çfarë të bëjmë! Ec e ec nuk dijshim kah shkonim.

Në mëngjesin e 14 gushtit 1998, na hetuen roja kufitare serbe.

Kërkuen me të mirë por na nuk ju ndalëm.

Pas vërejtjes tjetër filluen të shtien me armë.

Na me një shpejtësi dhe mjeshtri u larguem, ju afruem një kërrshi. Aty kishte qenë një shpellë.

## Të ngjuar në shpellë

Mezi u futëm brenda! Dëgjohej një uturimë(zhurinë). Nuk u vonuan dhe arritën tri tanke e disa ushtarë serbë. Ata u stacionuan aty. Çka të bënim ne tani?! Në atë vend, me Musë Çetën, mbetëm tetë ditë e tetë net. Ditën e nëntë dëgjova duke dhënë urdhërin për tërheqje.

O Musë i thashë, po largohen shkiet. Në mbrëmje dolëm nga aty dhe filluam rrugën tonë. Dikur u takuam me ca boshnjakë. U treguam rastin. Na dhanë ndihmë.

-Ju keni qenë më afër bjeshkës së Kolashinit. Shumë çudi si keni shpëtuar!

Shkuam në Vuthaj, na pritën shumë mirë. Na treguan se në Vuthaj ka shumë shqiptarë nga Kosova.

Nga komuna e Deçanit dhe e Pejës, nga Deçani, Strellci, Broliqi, Rastovica, Prilepi, Çetajt, disa familje nga

Barani, Juniku, Vokshi, Tafajt e Dranovcit, Mazniku, Isniqi, Rozhajë, Loxha, Istogu, Vrella, Studenica, Jabllanica e Vogël dhe e Madhja, Prigoda, Saradrani, Dubova e Madhe dhe e Vogla.

Mendova se krejt Kosova paskan ikur!

U kthyem te shtëpia me Musë Çetën, më 2 shtator 1998.

Mora rrugën për Jabllanicë dhe përsëri iu bashkova UÇK-së.

### Viti 1999

Nga Ruhoti u nisëm mbi 20 veta për të sjellë armë nga Shqipëria. Në mesin e këtyre vullnetarëve isha unë, Mergimi(djalë e babë), Kasimi djali i mixhës Rexhepit, Hamdi Ibër Berisha etj..

Kur arritëm në Jabllanicë të Gjakovës në mëngjes na urdhëruen se sante duhet të shkojmë për Shqipëri.

Kah mbrëmja na rreshtuan. Ishte Agim Zeneli, gjatë rreshtimit vjen Ramushi.

Ai më tha: ”Sa herë don me shkue ti Gani në Shqipëri”?

Shkon kësaj radhe Mërgimi.

Ju drejtova Mërgim Shalës, djalit tim dhe i thash, kur të kthehna prej Shqipërisë i ndjekim shkiet gjerë në Merdare.

Na quan në Ratkovc te Emrush Xhemajli.

Ai na këshilloi me pak fjalë: ruajuni rrugës, mos pini duhan vend e pa vend. Na thirri me emër për emër dhe nuk vonoj e duel e shkoj pasi na thirri emër për emër: Emrush Çeta, Gani Shala, Agush Gjoci, Daut Kelmendi, Agim Zeneli, Agron Rama dhe une ishim në fund të rreshtit, e përcillnim,...

Pak pa u nis më thirri Agim Zeneli.  
O Gani hajde e merre pushkën time.  
E morra pushkën dhe u nisëm!  
Kur mrrim në Kralan, na thanë mos ecni nëpër asfalt.  
Kaluem Kralanin, arritëm afër Erenikut. Kur ju ofruem  
urës, Agim Zeneli më tha Gani merre dikë dhe  
kontrolloje urën. E morra Emrush Çetën, tri herë e  
kontrollova rreth e më rreth.  
Nuk vëreja gjë.  
Aty paskan qenë dy ura: e vjetra dhe e reja!  
E thirra Agimin dhe ju dhash shenjë që të nisën.  
Agimi i kishte bërë gjashtë rreshta dhe ju ka thënë me  
shpejtësi duhet kaluar urën.  
Në gjysmë të urës u dëgjue një zë. Ndalo!  
Agimi ju drejtue kush je ti dhe mënjëherë kanë shti në ne.  
I pari plumb më muarr mua dhe kam rënë për toke.  
Agim Zeneli thirri, o Shalë a je gjallë. Po jamë.  
Gjuaj në shkie!  
Piskati Kasimi, o bac edhe unë u varrova!  
Kasimi dhe Emrush i më kanë kap dhe me kanë gjuajtur  
në lumë, për që mos të zihesha i gjallë nga serbët.  
Mbi 200 metra shkova teposht ujit.  
Vjen njëri duke vrapuar. O Kasim ndihmom, nuk jam  
Kasimi por jam Avni Elezi!  
Gani më tha Avnia, Kasumi është plagour shumë rëndë!  
Po të kërkon Kasumi. U ktheva të shkoj te Kasumi.  
Vjen njani këmbë e krye nëpër ujë.  
Tenton Avnija ta nxjerr.  
E heton se ai kishte qenë shka! Shka i plagosur.

E hoq Avniu pistoleten dhe ia shkrepri nja dy plumba.  
Gani tha: unë e nxorra vetën.  
Shkoj Avniu, unë u nisa zhag, e kalova rrugën, shkova të Kasimi.  
Aty kishin mbërritur edhe Emrushu dhe Agush Gjoci.  
Thirra o bac! --Jam varruar shumë rëndë!  
Bac nuk të lam vetun!  
Në ora 1 e dhjetë dha shpirt Kasumi!  
Piskati Emrushu...  
..mbahu Emrush he burr!  
Po Gani edhe unë jam i plaguar.  
Agush Gjoci tenton me i djegë kufomat.  
Agim Zeneli i tha jo Agush!  
Si vdes Kasumi i rash me dorë për fytyrë.  
I bëmë bashkë Kasumin dhe Hamdiun dhe nisem zhag m'i ngreh deri te një shtëpi dhe me i ruajt gjith natën, me i ruajt Emruesh!  
Vinë dy vëllazërit LLeshi. Kishin kërkuar një kolicë ne Bistarzhin, por askush nuk ua kishte dhënë. Ganiut ia morri në mëngjes revolen Nexhati e Emrushu dhe nuk u kthyen u vonuen shumë.  
Vjen Nexhati duke sharë. S'ka ndihmë Gani!  
Kah ora tre mbasdite vjen njëri dhe pyet a ka njëri këtu?  
Ju lajmrova unë. Më tha tash unë e lajmroj OSB-n.  
Shkoi!  
Nexhati përsëri nuk priti, duel për të kërkuar ndihmë.  
Por nuk i kishte ofruar kush dhe ai u vonue shumë.  
Ngadalë dola zhagas në rrugë dhe kërkoja ndihmë.

**Plaka në vend ndihmës, na shau dhe më rrahi pa mëshirë!**

Vjen një grue plakë. Oj Loke më ndihmo(m)! Po loke si jo më goditi me lopatë në krye, shpinë, me shau nënë e babë! Tradhëtar! Na prishët vendin ju muslimanët e poshtër...

Zhagas u largova nga ajo. Hyna brenda. Erdh Nexhati. Nuk u vonuan shumë... Ja erdhën OSBE-ja.

Ata me pyetën për emrin. Nuk ua dhash emrin e vërtet por u thash Shemsi më quajnë! Nexhatit i bënin lutje, hajde te ne. Menzi u bind me u afrua. Më përqafoi dhe shkoi. Nexhatin filloi OSB-ja me pyet?

Shemsi nga je dhe nga është shoku?

-Ju drejtova dhe ju thash ai është Nexhat Istref Berisha. E unë jamë Shemsi Shala nga komuna e Pejës, fshati Ruhot. Kasimi e Hamdija janë fshatar të mi. Na fotografuan e shkuen. S'u u vonua shumë, serbosllavët e armatosur, me pizgavera... erdhën dhe urdhëron komandiri ta dorëzojë armën.

I gova duart lart, u thash jam i pa lëvizshëm.

Erdhën e murren pushkën, pushkomitralozin që ua kishim marr shkive.

Me vendosën në lese tre maxhup, më dërguan të dyert e oborrit të maxhupit.

Me rrahën shuplaka, tjetri më binte në krye me shqelma, tjetri më pështynte! Nuk janë vonuar shumë e ka ardhur shefi i punëve të brendshme i Deqanit me emrin-maskënofkën "Vula" ndërsa komandir ka qenë Ahmet Hasku, kishin pasur kamerë.



Vula ja nisi të më pyeste. Si je ore djal (shqip), një shqipe të mirë, më vonë kam kuptue se ai e kishte krye gjimnazin në Deqan, në gjuhën shqipe?

Mirë i thash!

Po pse, pasi qenke mirë, pse don të shkosh për Shqipëri?

Rash posht në katin e dytë dhe pyeta disa deqanas, kush ka qenë komandiri me nofkën "Vula"?

Kush ishte gjakëpirsi me nofkën "Vula"?!?

Kryeshefi deqanas Vukmir Mirçiçka qen me nofkën "Vula"!

-Jam plagosur mbrëmë.

-Më tha, po mahitesh!

Më qëlloj me ca shqelma. U largua Vula nja dhjetë metra.

I shau shkau shkiet nënë e babë.

Qysh kanë qenë kaq afër e nuk i keni diktue!

Vula pyet: nga je?

Jam nga komuna e Pejës, fshati Ruhot.

Si e ke emrin?

Shemsi.

E qeli një bllok e më tha pi duhan Shemsi, se kam për të vra!

Unë nuk b'zana.

Një shka i pruni disa automatik, pushkomitraloza.

Ma ofruan kamerën. I ndëgjova duke thanë para kamere i kemi vra disa terrorista dhe ca i kemi zanë!

Vula: "Shemsi, kur të pyes duhet të përgjigjesh!"

-Ani i thash!

A ke qenë në Shqipëri?

Po i thash, 100 herë.

Ku është Gani Shala-Mërgimi, Kasimi, Muja, Nexhati, Qerimi, Ademi, Hamdija,

*Ju përgjigja:*

-Ganiu është në Jabllanicë, Mërgimi në Jabllanicë, Muja në Jabllanicë, Qerimi në Jabllanicë, Nexhati në Jabllanicë, Ademi në Jabllanicë, Kasimin e keni vra, Hamdiun e keni vra!

-*Vula*: Shemsi a i njeft; Qerim Osmanin, Adem Shalën, Tafil Avdylin nga Tresteniku, e Vëllazërim Berishën.

Ju drejtova: Po tan i njoh.

Ai mu përgjigj se mbrëmë tanë i kemi vra!

*Kush ju ka pri mbrëmë:*

-Unë i thash, unë jam kanë përgjegjës i tërë grupit, me Kasimin e me Hamdiun.

Vula me tha shumë mirë, por ki me thënë se mbrëmë ju ka vra Ramush Haradinaj!

E dhezi kamerën, kush ju ka vra mbrëmë.

Ju na vrat mbrëmë!

E msheli kamerën.

I urdhëroj maxhupët që të më qojnë në livadh.

***Vula i Zi i vrau edhe një herë për së vdekuri dhe shtiu për së gjalli në Gani Shalën!***

Më qun në livadh, aty pash Kasimin dhe Hamdiun.

I kishte mbulue bora. Dimër.

Nuk pata mundësi t'u fshija borën, më shkuan lotët.

Mu afrua Vula më tha "***Shemsi thuaj Ramushi i ka vra mbrëmë***"!

Kurr nuk them, vram!

Ju afrua Kasimit më revole i ra krye për së vdekuri!

Pastaj ashtu ia shkrepni plumbat edhe Hamdiut.

Vula nuk mbeti i kënaqur më ketë, ai mu afrue dhe mi shkrepni edhe mue dy fishek në këmbën e majtë.

### ***Thuaj Ramushi!***

Jo i thash kriminel.

Ramushi është hero, më goditi në këmbën e djathtë tre herë. Humba vetdijën.

Më kishin pas dërguar në spital në Gjakovë!

Gjakovë: Duke më dërguar në sallën e operacionit, lakuen për “kapellë” para meje i kishin qar shokët dhe bashkëluftëtarët e mi, Kasumin dhe Hamdiun dhe Daut Kelmendin. M’pyetën për Kasumin, u thash vlla e kam.

Po Hamdin, -e kam të katundit.

Dauti është i banjës së Pejës.

Dërgone tash Shemsin në sallë. Mos mujshi ju e qojmë ne për Greqi ose për Rusi.

Selajdin Boshnjaku ju tha nuk ka nevojë me que kërkun se une e bëj operacion. Ia shan nanë e babe.

Dr.Selajdini me stafin e vet më operuan.

### ***Dr.Selajdini këshillon!***

Më dërguen në “shokë sob”, erdhën shkiet dhe menjëherë më lidhën këmbë e duer për krevat!

Në mëngjes ia mbërrijnë policia me gjyqtar-paditës-prokuror.

Gjyqtari hetues;

Si po ndihesh tash shokë komandant?

-Nuk jam komandant.

-Mshele gojën kriminel!

-S'jam kriminel!

-Ju dha urdhër mem zgjidh këmbësh e duresh!

Gjykatësi hetues më tha ndeze cigarën.

Si e dheza mu qelën pak syet...

-Shemsi a je kan ndojhere në Shqipëri?

-Po jam kanë 100 here, apet shkoj si të kam mundësi kur të shnohna!

Shemsi ku është Gania?

-Në Jabllanicë.

-A ka shumë ushtar?

-Janë diku mbi 5000 ushtar, 1000 janë muxhahedin!

-Shemsi kah keni ardhë deri të ura?

Për Kralan.

Kush ju ka pri?

-Unë.

-Atëherë Shemsi ti qenke komandant?

-Jo nuk jam.

-A je?,- s'jam...!

-Por mbeta sipas tyre unë komandant.

-Mi lexoj nenet; Pikat; 125, 136, 139, 142

-Ju drejtova në fund gjykatësit;

-A gjen konop që të më varësh në Kosovë?

-Mos paçi shkoni të UÇK-ja, se ta japin!

-Me tha shihemi në Pejë.

Mbas tri dite më dërguen në sallë. Me operuen për të dytën herë. Në mbramje erdhën shkiet, më kishin pas lidhur përsëri për krevat.

I shava nënë e babë: Prej Milloshit e deri te korrili.

Nuk b'zan e shkuen...!

\* \* \* \* \*

Të nesërmen shkruajnë gazetat, çka bënë shkijet nëpër spitale të Kosovës, konkretisht i Gjakovës.

Mbas dhjetë dite erdhën e më than duhet me lëshue “shokë” dhomën. Me quen në tjetër dhomë. Tue bisedue me Gjokën, Ndrecën, erdh Dr.Selajdini dhe më tha Shemsi po dojnë me të que për Pejë!

Ja mbrinë disa polic më murren, më qitën në kerr. Një motër m'i dha 25 hapa apuarin dhe më tha me i përdor për çdo mramje nga një.

Çka me pa dhjetë kerre para, kerri i ndihmës në mes dhe aq prapa meje! Helikopteri përmbi nesh ndëgjohej!

U gjallërova-krenova, i thash vetit kokna berë vërtetë komandant! Kur mbrina në Deqan i piva të gjitha hapat, thash të vdes pa mbrri në Pejë, por nuk vdiqa, nuk më bën asgjë.

Te spitali një qetë shkie duke më prit!

Ja nisën të më rrahin, të më shajn...

Fati im u duel përpara Mit'hat Jakupi, u ndalën dhe më quen në dhomë.

Nuk vonuen dhe ja mbrini gjykatësi;

Daktilografja më pshtyeni, shajke...

Gjykatësi ishte Dragan Boiq. Ai më tha: Shemsi informatat i kemi, krejt me na tregue;

Prej 56 e deri me sot?

-Unë i thash, nuk dij për 56, por 55 vjet i kam.  
-Ke qenë në demonstrata?  
-Jam kanë, ju kam pri atëherë dhe sot u kisha pri!  
-Gjykatësi duel jashtë.  
Vjenë Bajram Tallamishi, më thirr: o Gani!  
Nuk jam Gania!  
Shokë komandir, ky nuk është Shemsia por Gania vet!  
Pse po rrenë, maxhup i thash!  
-Më ra shkelëm në bark.  
Më ra hu, dhe e bëri llom Bajrami.  
Vjen pas tij Sylë Dollci. O Shemsi!  
Shokë komandir ky është Gania!  
Shkoj Sylë ma pruen Zeqir Demën, ju tha ky është  
vërtetë Shemsia. Ju erdh inati. I ran Zeqirit!  
Afrohet gjykatësi dhe me tha:  
Shalë je i ngarkuar me këto nene: Pika 125, 136, 139,  
142... Shkoj gjykatësi...  
Në mramje ja mbrini Shani Puri, një kriminel i njohur  
për shqiptar!  
Më ra dhe më shau, ju tregoj mjekëve dhe del!  
Mit'hat Jakupi jep opinionet se çka bëjnë zi në spital mbi  
të plagosurit, veçmas ndaj Gani Shalës!?

\* \* \* \* \*

Të nesërmen ma bin gazetën, se pranoj kurrsesi emrin!  
Gjithashtu rrezikon Çelë Alia e tërë stafi mjeksor i Pejës,  
veçmas Mit'hat Jakupi.

*Pra shquhën:* Dr.M.Jakupi, Çelë Alia, Atifete Shala, Fatime Shala, Rexhep Mavraj dhe Fatmushi nga Trboviqi.

\* \* \* \* \*

Më dërguen një natë në burgun e Pejës. Mithati mi dha teshat e veta, Atifeti qorapat, Opinionin vendor dhe të jashtëme e informoj Mithat Jakupi.

Ndëgjova tue thanë shkiet se M.Jakupi i ka njek mjekët e Shkupit. Mu më erdhë shumë mirë. Mithati ishte në spital i pa korruptuar, atdhetar, për këtë kisha shkruie me ditë dhe javë, muaj e vite të tëra.

Ai bëri shumë për mua gjat luftës sa nuk dij t'a përshkruaja.

Unë si Gani, **Mithat Jakupit** i përkulëm në gjuj, e as një mjeku tjetër!

Pas lirimimit nga burgu ndëgjova se Mit'hati e kishte ngarkue strajcën me barna e ishte ngjitë bjeshkës, kalon kufirin dhe bjen në Rozhajë. Atje i ka dhanë ndihëm ushtarëve të lirisë dhe shfrytëzoj rastin edhe një herë t'a falënderoj.



**Gani Shala në krraba afër urës ku ishte plagos**



## **Transporti me helikopter nga Peja deri në Nish!**

### **Më 6 shkurt 1999**

Në ora 5 të mëngjesit erdhën e më murrën nga burgu i Pejës. Më qitën në koridor, ma futën një thes në krye, më lidhën duersh e këmbësh, me vuen në lese (bartëse), më shtin në kerr, dhe më quen drejt Radavcit ke postblloku.

Më zbritën në tokë, më than prite Ramush Haradinin!

Nuk bëzana!

Vjen një polic e më thirri: O Gani, çka u bë bre kojshi?

Jam nxanë duke shkue për Shqipni, aiii Gani smuaj gjë me të ndihmue! Jam unë Gani, djali Dushan Babiqit.

Gani më tha, vjen me të marr helikopteri.

Nuk vonoj shumë ia mrrini helikopteri i Serbisë, me murren ngadal, më qitën në krevat. Në at helikopter kishin qenë tre ushtar, piloti e një motër e spitalit. Mbasi u nisëm u afrua një ushtar e më ra shuplak!, më kapi për veshi, më therrke me një tel, çka nuk dinte tjetër të bënte!

Mbrritëm në kazermën e Nishit. Zbriti helikopteri dhe piloti e ushtarët. Arrijtën dy ushtar dhe më thërrasin ku je komandant...? Nuk bëra zë! Shkina ju tha ky ka dasht mem ç'njertzue!

Njëri ushtar ia nisi mem rraf!

Pse e nguce motrën?

A po e shihni se jam i lidhur duersh e këmbësh, qyesh e paskna nguc une more kriminela!

Prej Nishit e deri në burgun famëkeq të Beogradit, në CZ më kanë rraf.

Si zbritëm, dolën mbi 50 komandira, gardian,.. Dikush me shkelma, dikush më shkelke, të gjithë llum më bën!

Pasi u larguen mi lëshuen qent, më hangrën dhe më ngrehën zhag!

Kur më lan qent në koridor. Aty e pash Xhokën.

O Shalë a je gjallë, bërtiti Gjoka?

Po shef si jam gjallë!

Vijnë pesë veta dhe popi me ta, më shtin në një dhomë.

Popi më tha, ku je komandant?

A je kan komandant?

Po jam kan dhe jam.

Deshe kmishën.

Jam i lidhur si të deshna unë.

Më shliruan dhe pastaj e hjeka kmishën....

Me ngjyrë të kuqe ma bëri kryeqin!

Ngjyra kishte qenë llak. Më tha veshu.

Si u veshu, më pagëzoi dhe më tha tani e tutje e ke emrin Shajnoviq Llazar!!

Mbi pesë kile e muerr një kryq me zingjir e ma vuni në qafë me një dry.

E thirri Xhokën, ia heqi llanacin, ja nuen kryeqin, e pagëzuan me emrin Markoviq Marjan.

Ju drejtova Xhokës, je shqiptar?

Me kryeqa smahet shteti Gani bënu i fort.

Na quen në podrum.

Kur rava në podrum, m'i dhanë dy qebe, më shtin në një dhomë me mbi 40 bira të mijëve.

Pava shumë minj.

Na ndalën rrymën.

Mbas një ore ma pruen do bukë.

Një komandir pshtyeni në sahan, mi qiti tri lug çorbë.  
Si ma nali rrymën, kcyen mijt në sahan, menzi e morra  
bukën.  
Për natë më rrafshin, ren pas reni!  
Tri lug qorbë, 100 gram bukë.  
E shtisha bukën në sholë, pija ujë,... Deri nja dhjetë ditë  
ndoshta e kam dijt kur është natë e kur është ditë!  
Në njëzetë e katër orë me jepnin pak bukë!!

## Njëdhjetë mars 1999

N'ora dhjetë më thërrasin, thretet Shainoviqi.

Hajde se ke vizitë.

Më quen e më pastruen!

Ma futën një maic në fyet, ngadal me quen.

I pash dhe i identifikova: Shaban Halilin, dajën e babës, nga Sferrka, dhe djalin e axhës Adem Arifin.

Njëzetë minuta ndejem bashkë dhe shkuen.

Kur më kthyen pas, më ndalën në koridor, dikush bënte hajgare, dikush këndonte një këngë ku thonin: në djep fëmijët kemi me jau pre, ska Kosovë më, rrafsh e kemi bërë...

Unë nuk bajsha zë!

Mu ofrue një komandir i burgut më tha: Shemsi, hajde se jam tue e dijtë se Serbia mbaroj, e shiqova e ai e kuptoj, më tha unë jam malazez.

Tjetri tha: po të qojnë në varr masiv!?

More terrorista, atëherë më ra ndërmendë se gjatë demonstratave naj i patën ngjitë emrat edhe shqipfolsit, bashkpuntorët e Serbis: Terrorista, kanibalista, shovinista, vagabonda etj... Ku e keni Ramushin, ku e keni UÇK-ën,...

Më quen n'at dhomë të shkret.

## Binduni se kanë pirë gjak timin dhe të Gjokës!

### Bombardimi i Beogradit

**Me 24 mars 1999**

N'ora tetë e mramjes fillon bombardimi i Beogradit.

I ndëgjova komandirat tue sha Millosheviqin!

Nuk vonuen shumë, erdhën dhe na prunën bukë, mos u tut, më dhanë edhe duhan, një litër sok. Shkuan!

Ja nisa me këndue.

Të nesërmen në mramje janë ardh komandirat dhe më qitën në korridor. E pava tue i ra me ram të prozorës krye Mendova se e mbytën.

Gjoka i shau...,e lan Gjokën më mësyen mua...

Njani më ra me një hekur në krye, më rrëzoj.

Mu lëshue ngerrhamza, mu lëshue gjaku.

Binduni se kanë pirë gjak timin dhe të Gjokës!

Në mëngjes, mendoja se kurr nuk do dal nga burgu!?,ditët kalonin shumë ngadal!!

Një ditë nuk e di cilën, me murrën me lese, më than po të qojmë në varr masiv!!

Më quen në spital ushtarak.

Çka me pa aty; ushtar pa këmbë, pa duer...

Një ushtar më veti nga jeni?

Nga Kosova ju përgjigja.

Me shajke, smujke me u que, ishte pa këmbë.

I thash gati koke mu shëndosh, bile shetitesh nëpër Beograd me kolicë!

Desh u tranue kur i thash!

Më dërguen në sall të operacionit. Me operuen pa pik narkoze. Lotët më shkonin e u përpiqeshin në mjekërr.

Pas operacionit ma vuen gipsin në këmbë.

Mjekët ju thanë qone për Novi Sad, drejt në operacion!

Me transferuen për Novi Sad. Drejt në sallë. Duel mjeku i Pejës Rade Repac, më tha mos prano me u operue unë nuk jam në sallë. Unë jam nga Peja, malazez, kam punue në spital të Pejës.

Ju e keni Mithat Jakupin.

Po i thash Mithati i ka ndjek ortopedët e Shkupit-Maqedonis se i kanë pa lane sakata popullin.

Ra Mithati e i ndjeku.

Po Mithati ka shumë merita.

Unë jam varrue në Gjakovë, I pava tha dokumentet tua Shemsi

Mue profesor më ka pas.

Nuk pranova me u bë operacion. Më kthyen përsëri në burg në Novi Sad!

Në hyrje të burgut rraheshin disa të burgosur.

Më quen në dhomë.

Mbas pak ia mbrin disa komandira, më thershin me gjylpana, mi vuen në gishtat e këmbëve. Sdi edhe ... mem bërë. Mbas mرامي më kapën për kalemi, më përgjakën...

Dulen kriminelët jasht!

Rash pak me pushue.

Ma pruen bukën dhe dy molla.

Një shqiptar kishte qenë komandir, ma dha një pako duhan.

.....

## **Odisejada e transferimit të burgosurve në vitin 1999**

Te nesërmen në mengjes na than kemi me të que për  
Srmska Mitrovica!

Aty mbrina me 6 prill.

Me dhjetë prill në Pozharevc,

Më 11 prill në Leskocë,

Me 12 prill në Zajeqar,

Me 18 prill në Nish,

Më njëzetë prill në Krlevë,

Me 27 prill në Prokuplje,

Me një maj në Prishtinë,

Më 13 maj në Dubravë

Krejt kjo levizje e kishte prapavin, thyerja shpirtrore ishte  
qëllimi, kulmi i barbarisë dhe maltretimët e bënin edhe  
më të vështirë këtë odisejadë

<b>-Avdija të ka rraf!</b>
----------------------------

### Me një maj 1999 në Prishtinë

E pava njanin tue nda bukë. Si je more shokë me tha, mirë jam i thash! A po më shef...

-A më patriot je ti apo unë?! Jo more shokë, unë di për veti e jo për ty!

Unë jam kanë tre vjet me pushkë në dorë në Kroaci, e dy vjet në Kosovë! I erdh inati e me shau nënën e shqiptarit, gjakun!

Më sjelli me një gjokër krye e shpinës! Më qojë në një sobë, aty pash disa, me murrën, ma pastruen gjakun.

Njani prej atyre shokëve me tha: *Avdija të ka rraf!*

Pyeta njanin nga je? Nga Doganajt e Kaqanikut mu përgjegj. Ai vazhdoj duke thënë se jemi ushtar të UÇK-ës! Nuk i besova!

Njani me pyeti për emër?

Ju thash unë jam Shemsi Shala, nga komuna e Pejës.

Tjetri më tha: a je i plagosur?

Po jam i thash.

Po ku je plagos, -në Gjakovë ia prita. Njanit i shkuen lotët! Kur ma pau kryqin në gjokës.

Mu drejtue: Shemsi unë jam Hasa Dallosi, ky Ahmet Hoxha...

Rasti thon është mbret i botës, kush e ka mendue se do shifemi dhe do njifemi përsëri sepse ishim të dërrmuar nuk e njifshim njani tjetrin!



<b>Kur ma pan kryqin në gjokës...</b>
---------------------------------------

### Me 13 maj1999

Me 13 maj na qesin n'borr për të shetit.

Pash Gjokën. Pava shumë autobusa.

Një kriminel me muerr e me qoj të një kerr, me hypi ngadal pasi ma pa kryeqin në gjokës, duke mendue se jam shka!

Kur u nisën autobusat, na ishim ma të mramt.

Kur kemi mbrii afër fshatit Llazicë janë ardhë bombarduesit, kanë fotografue, ndëremjet autobusave kanë qenë tankët. Kur mbrijtëm në LLazicë erdhën bombarduesit, ju ran tankave, tana i shkatruen.

Urën e këputën!

Si kaloj rreziku, hym në autobus edhe shkiet n'autobus.

Shkiet me thika ju binin të burgosurve. U ofruen tek unë.

Kur ma pan kryqin në gjokës, me thanë; **"Deqesh"**?

Ju thash, **znam ja!**

Shkuen shkijet, na shtinë nëpër fshat në LLazicë. Ja dulem në krye dhe drejt për Dubravë. Në Dubravë na pritën shkiet para burgut. 100 shkie me huj në dorë, ca lopë kullosnin!

Me than te drejtohena në derë të burgut. Njizetë metra pa hye n'oborr të burgut, pallën lopët. I shava në nanë e babë. Krejt lopët i paskan prue këtu, lopët qe i kanë vjedhë.

Nuk e kisha pas pa shkaun pas meje! Më kishte ndëgjue! Me ra mbi 30 herë palicë. Hyna zhagë n'oborr të burgut. Përjasht burgut shkojke kukama. I bën tanë llam...

Tue shkue në pavijon, u rrëzova nuk mujta ma me vazhdue! Erdhën dy veta e më murrën zhag.

Më quen në pavion C, në izolim. Apet u takova me grupin e Kaqanikut: Ahmet Hoxha, Hasa Dalloshi Mehdi, Tefikun, Muslin, Fatmirin, dhe Sejdin.

Këta kanë qenë grupi i Kaqanikut, por edhe disa tjer.

Si: Tahir Panxhën, Dervish Sylën, Sylë Kuqin, Ismet Musën, Rasim Selmanin, Rasim Jahën, Shaq Selmanin dhe shumë e shumë të tjerë

Për natë i rrafshin, bukë nuk u binin.

Hasan Dalloshi u kujdeske për mue.

<b>E murrën mr.prof.Ukshin Hotin vet të tretin</b>
--

**Me 16 maj 1999**

N'ora dhjetë filloj sulmii NAT-os mbi pavijonin C  
 U vra Gjoka vet i treti, nja i balajve. I shkoj tymi e flaka  
 pavionit. Ndhët britma! Bërtiti Hasani, C-ëja u kall..  
 Rama, baci Mehdi, shkuen me i thye dyrt! Qe e pava, o  
 Gani Nimanin, mu këthye Hasani: qysh e ki emrin?  
 E kam të ndrruem i thash.  
 Hasan Dalloshi, Naim Rexhë Kurmehaj dhe Ismet Musa,  
 me kazem(tarrakop) i thyen dyert. Gjashtëdhjetë dyer i  
 kanë thye me 19 maj 1999.(Gani Shala,dv)  
 Pasi dulem të gjallë nga C-eja, pasi u kall. Dulëm në  
 oborr. Na quen në shkollë. Shkoj Naimi e më pruni bukë.  
 U ulëm një qosh, e thirra Hasanin. Mendova se nuk muj  
 me dal i gjallë me i tregue!

<b>Hasan, unë jam Gani Shala</b>
----------------------------------

Po të tregoj Hasan, unë jam Gani Shala, jam më emër të  
 vllajt. Hasan nu vrafsha, shkon të shtëpia, ju tregon për  
 mue.

Gani ama adresën: Ja dhash.

Hasanit i shkuen lotet. Ma dha besën.

Naimi më tha Gani,e thyen shkiet zitin e oborrit, a mujm  
 me ik. Po Naim, me i tregue Hasanit nga Doganajt e  
 Kaqanikut, me Dervish Sylës, Rasim Jahës, Rasim  
 Selmanit, Shaq Selmanit, Ahmet Hoxhes, Tefikut etj.

Naim kur të bëhët aksham, unë ju pri e ju qoj në Ruhot.  
Tentuem natën me dal, por nuk mujtëm! Tentuem dy netë  
me rradhë e nuk mujtëm!

## 1 qershor 1999

Përsëri sulmoj NATO-ja duke fillue n'ora 9. Vrahët  
Ahmet Hoxha, skaj meje. Mue më nxuerr nga dheu  
Hasan Dalloshi. Vazhdimisht sulmojin Natoja. Rava  
përmbys, mi mue ra Tefiku e Hasani

### **Mua me mbuloj dheu.Hasan Dalloshi me nxuer prej dheut**

Tefikut i thash pse rave mi mue?

Mos bënë zë.

Dojmë me të shpëtue ty Shemsi!

Ra një predhë në shokët. I bjen në shpinë e krye Tefikut.

Hasani u que dhe tha kaloj sulmi.

Çou baci Tefik, ma hjeku Hasanin, Tefiku. Prej shpine të  
vdekur!

Naimit ju kish pas këput kryet!

Hasani ia muer trupin Naimit, unë zhag kryet.

Hasani e muerr Ahmet Hoxhen, i bam bashkë.

Naimi ishte nga Strellci i epërm, Tefiku nga Kaqaniku.  
Ahmet Hoxha nga Ferizaj, Hasan Maraj: jeta e  
jonë..Shkuem në fushë topi gjithë ditën e natën e bëm  
aty.

## Me 22 maj 1999

Na lajmruen me atoparlant: Ska jetë më në Dubravë!

Bënu rresht afër zetit.

O Hasan dojnë me na vra.

Jo Gani!

Hasani kqyri në Karakullë ishin me mortaja. Mos u tut Gani!

Sjam kah tutna! në gjasht rresht, Nuk vonojnë, ndoshta sekondat dhe me tana armët shtinë në neve.

Unë rava pa gjuajt!

Kur kanë gjuajt, i kam parë dhe numrue tridhjetë veta të vrar, edhe mbi mue, menzi merrsha fryemë! Na mbuloj gjaku! shkon kukama!

Ndëgjova Dervish Sylën tu sha, bërtitke: "Rrnoftë UÇK-ja: Rrnoft Ramushi! Amanet Hasan e Shemsi! lajmromani shpin! Thuni nënës e shoqës, rumni femijt.

Pra këtë amanet ia la Hasanit dhe Shemsis në plojën e Dubravës!

Nuk vonoj shumë dhe ia pren me thikë kryet shkiet!

Gjith ditën kanë gjuajt në të burgosur. Mezi u bë aksham. Menzi i largova të vdekurit që i kisha në shpinë dhe për rreth. E luta zotin që të na ndihmon. Zhag, menzi dola e kalova zidin dhe dola n'oborr të burgut. I pava dy traktora plot gjin të vdekur!

Plot rovat gjin të vrarë. Qashtu zhag e zhag hyra në mal. Skaj kishës se shkive i jam ofrue Istogut krejt skaj malit, kah mengjezi, pas bazenave të peshqive. Aty diku afër pava një livadhë me bari siq thuhët deri në fyet. Më kish pasë zanë gjumi, me tahmin kah ora nëndë mbasdite u qova.

Zhagë nëpër lluga, vija deri kah ora një pas natës mbrina të ura e Istogut. Nuk guzofta me kalue arën skaj ujt. Ec e ec, mendova se jam avit, të varret e Prekallës. Hyna në ujë të Istogut, gati u mbyeta! E kalova disi ujin. E shkeva këmishën dhe e lidha varrën e u nisa zhagë i kalova varret e prekallës. Hyna trup, kur rash te shtëpia thirra: Zdel askush! Me hye brenda nuk muejsha! Tue nejt mendova: Po shkoj të Binak Rama.

I vëreja nja 12-13 ushtar të UÇK-ës O n'ore të juve, jam i varruar! Jo gabim këta qenkan ushtri e rregullt e serbisë.

Me thanë qoj duert nalt! I qova. Më quen në malë të Prekallës. Me ushtar kishte qenë një kapiten.

Me veti për çka ke qenë në burg?

E kam vra një të fshatit për tokë.

Sa ke qenë i denuar, -15 vjet.

Kur e ki vra?

Qe 14 vjet e gjyes!

E shau gjykatën, për një shqiptar 15 vjet burg, a.

I thirri do ushtar me ma pastrue varrën në këmbë?

Ma lidhën varrën, u bë sabah.

Aty pash tri tanke, shumë ushtar.

Kapetani më dveti, kur ki hangër buk?

I thash qe tetë ditë!

JU bertiti: bjeni shokut bukë.

Ma pruen një bukë, një sahan çorbë.

Për tre minuta e hangra!

Më veti a e pin duhanin, i thash po! Më pruni duhan.

Më tha jam nga Vojvodina. Pasha thmin njerëz të gjallë ska në Pejë. Me të lëshue unë te vrasin shkiet qe i kanë shamijat në krye.

Mu drejtue kapetani: Kush ju ka vrarë në Dubravë?

Natoja me nëntëmbdhjetë maj.

Janë vra tre veta, me 21 maj, 18 janë vra nga Natoja.

Me 21 maj komandanti i burgut, zevens komandanti i milicis së Mitrovicës me dha një leter, hyp në kerr për Dubravë.

Ram për Porekallë, Zabllaq, Zalq, Gjyrakovc, Istog te burgu i Dubravës pava një kamion me caradë të luls.

Plot kamioni gjin të vram, i kipiratën!

E njeva kapetaniin tue thënë sda gjynah, shau Millosheviqin! Ju thonte kapetani: Prej Mehes i kan prue në Dubravë? Te dera e burgut njerz të vrar, diku ka 60 veta.

Një komandir nga Banja e Pejës, Villastra Petroviq, me thikë tue u pre gishtat, ja u merrte dukatin, duet ua hjeke, ua merrke sahati,...Më bertiti hup mos të shof këtu, me i tregue kujt, kryet ta hjeke! U largova. Pava të burgosurit. Pyeta për Hasan Dalloshin, -më than rri qetu se po e thërrasim. Su vonue erdh Hasani.

O Gani ku je?

Qe Hasan.

Me muer Hasani dhe i tregova krejt ngjarjën.

Gani mos ta din askush. Ani Hasan i thash. Tue ec me treguen ken e kan vra nëpër shakta. Mbi 180 veta janë të vrarë, 300 janë të varruar. Hasan jashta zitet dy traktora plot gjin janë kanë të vrarë, plot rovat.

Hajde Gani mos ben zë.

## Me 24 maj 1999

Na rreshtuen dhe na hypën nëpër autobusa. Drejt na quen në burgun e Lipjanit. Tue shkue më tregonte Hasani çka ka ndodhë! Kanë vra nëpër shakta, skan lënë gjë pa bërë. Veqmas Halitit ja kanë vra vëllajnë me revole!

Gani u vran tërë shokët që janë kanë në grup me ty!

Gani mos ta din kush emrin!

Gani ka shumë shpiuna.

Hasan me kanë mbyet por nuk kam kallzue asnjë emer.

Gjithashtu Hasani me njoftoj edhe për të plagosurit:

1. Tahir Panxha,
2. Bedri Kukala
3. Ismet Musa,
4. Sylë Kuqi,
5. Gjelal Canziba,
6. Rasim Selmani,
7. Shaq Selmani,
8. Fatmir Kukullari,
9. Rasim Jaha
10. Reshat Nurboja,
11. Hysen Bahtiri,,
12. Defrim Kiqina,
13. Hasa Zariqi,
14. Halil Ademi
15. Gani Çeta, e shumë të tjerë.



**Tahir Panxhën** e kishin marr tre plumba snjaperi, e kishte gjendjen shumë rëndë.

Nëse tash nuk vdes ai kurr nuk do të vdes. Ia kanë lidhur varrët, shumë prej të plagosurve kanë shkue zhagë në depo, i kanë thye xhamat, jane hye brenda e kan marr barna!

E pyeta si je baca Tahir > jam lodhur. Me hajr varrët. Nejta pak me të në autobus duke shkuar për Lipjan.

Kur arrijtëm në burgun e Lipjanit;

E njajta atmosferë.

Ndëgjohej britëm, shifej kudo gjak.

Më priti një polic befas pa as një shkak.

I thash pse më rave more idiot!

Ma kthej: tanëve kemi mu bërë varr masiv!

Kemi me ju...

Tahir Panxhes > Ju drejtova, pse spo e vrani, tha njani.

Qetash edhe ty, erdhën e më rrafën.

Tahir Panxha ju tha: Ah kriminel, posht Serbija, > Nuk b'zanë, na ndan me Tahirin e me Hasanin!

## Më 10 qershor 1999

U grumbulluen shumë autobusa. I hipnin të burgosurit dhe na quen për Nish. Hyem n'oborr të burgut dhe thanë drejt për Pozharevc.

Si u nisëm populli i Nishit na shajshin dhe gjuejshin me: kompira, patligjana, gjama, dërgoni thonin he k...shqiptare ne varrë masiv!

Disave ju hyeni friga që po na qojnë në varrë masiv!

Prezenca e Isuf Kelmendit edhe pse ishte në sherbim të tyre na ka pshtue se ndoshta...Na nisen drejt Pozharevcit.

Si mbririm në Pozharevac, ja erdhi Isuf Kelmendi në qeli.

U hap dera e autobusit, zhdrypim ngadal. I pari ishte Tahir Panxha, pastaj Sejdija nga Ferizaj, zbriti Hasan Dalloshi, e unë, krejt na quen, 85 vet në pavilionin 6-të.

Një sobë e madhe. Erdh një komandir e me pyeti: Ti më trego kur keni hangër bukë? I thash; Qe njëzetë ditë dy herë nga pak. E shau nënë e babë Jugosllavinë! Më tha tash ju bin bukë dhe vërtetë na pruen.

Ti Shalë ke me shkue për Beograd. A njëherë dojnë me të que në operacion! Pa opinium... Një i burgosur m'i kapi veshet. Ma fort më dhimshin veshët se sa këmba! Me hypën në kerr, drejt në burg. Pas dy orëve mbrritëm në Beograd-CZ dhe me quen në të njajtën dhomë. Aty e gjeta Tefik Varoshin. Ishte i varruem në Dubravë. Më pyeti: Shalë afrohu më afër, jam pak i varruem! Shalë...

Jan ardhë e me kanë qiten në hodnik. Për kalemi me ngrehshin zhag, mi shtijshin telat ndër thoj. O zot merrma shpirtin! Zhag me quen të Tef, tue kajt o baci Faik. Gajret burr! Ska më gajret! Ma pastroj gjakun! Më tha koka terë. Pasë tri dite e murrën Tefikun e më lan vetun!

Me 21 gusht erdhën e me qitën në koridor. Me quen me ec, më urdhëruën; Mbushe me doirë papuqe të fliqët, e mbusha, më than hape gojën. Një orë mbaje më dhëmbë papuqën më të fliqët. Skisha çka bëj, o zot nimom!

Më quen në dhomë. Terr, bukë nuk kisha, luajsha me mij. Ku më grrithshin mijt, mu krujke trupi.

Me një shkurt janë ardhë e me thanë shkruju: Se është vdekë Tefiku vet! Ani pse edhe për gjashtë vet kam shkruë-nënëshkrue me zor!

Ju i kini mbyet....



Gani Shala në kurim

## Me 2 shkurt 2000

-Erdhën ke dhoma, ma qitën një bezë në kokë dhe me quen në sup. Mbas pyetjeve me quen drejt në Beograd të Ri, në gjyq. Tri ditë rresht në gjyq, por unë nuk shifsha kurgjë! Tetëmbdhjetë muaj pa dritë as diell, pa u la, pa u rru, copa copa teshat, plot morra kryet, i plagosur, i rrafur...

## Me tetë shtator, 2000-tën

Kah mesi ditës ndëgjova se kisha vizitë. Kësaj radhe nga kryeqi i kuq ndërkombëtar.

Me lese me kanë qitë nga spitali i CZ-ës. Kanë qenë ministria e burgut, kryqi kuq ndërkombëtar. Dikush folke, dikush qante, dikush luate me krye...

Me murrën në pyetje.

*Ju tregova:*

qe 18 muaj nuk kam pa dritë as diell me sy, pa u la, pa u rru, copa copa teshat, plot morra kryet, i plagosur, i rrafur, ska vend që spom dhëmbë..

Dr.Nedelkoviqi më ka thënë duhet me hjek këmbën! Unë e kam pranue! Siq thsh më lart qe 18 muaj skom pa dritë as diell me sy, në vetmi, më kanë shti me nënëshkrue për gjashtë shokë gjoja që kanë vdek vet. E kam krye gjyqin në Beograd, emrin ma kanë ndrrue, kqyre kryeqin si ma kanë vue.

Pastaj me dvetën për Dubravë:

-A din gjë për familje, jo ju thash qe dy vjet!

Mos ke dert se tani e tutje ne e lajmrojmë familjen, ne tani e tutje kujdesemi për Ty.

Njizetë ditë ke me ndej qetu. Na vim e të marrim. Me pruen bukë, soka, tesha, dhe duhan. Këto tesha vishi për çdo ditë.

Në një mengjez më lajmrojnë Shalë ke me shkue në Pozharevac, në rigjykim. Kur shkuem te dera e burgut, më ndalën, më rrafën krejt Pozharevci. Tmerr! Zhag më quen në pavilonin 6-të.

*Me duelën para:*

1. Rasim Jaha,
2. Skendër Hoxha,
3. Ekrem Bajrami,
4. Ismet Musa,
5. Zeqir Gashi,
6. Fadil Krasniqi,
7. Halil Guta,
8. Defrim Kiqina,
9. Hasa Zariqi,
10. Halil Ademi,
11. Gjelal Canziba,
12. Hazir Islami,
13. Bedri Kukala,
14. Smajl Hasi

Kur hyna në dhomë të gjithë u befasuen!

O aje gjallë Shemsi?..., në refrën. PO jam gjallë...

Në vrap ngan Zeqir Gashi nga Broliqi, i thot Rasim Jahës, ti me Ismet Musën gjani tesha, unë po ju hjeku flokët, me lan Rasim Jaha e Zeqir Gashi e me veshën pas 18 muajsh!

Të nesermën ja mbrini Isuf Kelmendi. Më kërkon mue, shokët i thojnë ai është i palëvizshëm!

Ju ofrue afër dhe po e dvet si je Shemsi - si ka thënë Zoti! Shemsi nesër ki rigjykim. Shokë, Unë e kam krye gjykimin në Beograd!?

-E dij tha. Përkthyesit ju drejtova më ska nevojë përkthimi.

Pyeti Isufi, o Shemsi i kahit je?

Tue desht me i thanë i komunës se Pejës, ndërhyeni, unë nuk po të dveti i cilës komune, por i kujt je?.

Prej Ruhotit i Sylë Osmanit.

Ti je Ganija.

Jo jam Shemsia.

Gani une e dij punën tande, mos bënë za, une neser vij me ty në gjyq.

Gani fshati kanë qitë parë për ty, ki me shkue në shtëpi.

Të nesrit më murrën bashkë me Isufin, shkuem në gjyq.

Më denuen dy vjet! Shtatë ditë pa i bërë dy vjet me lëshuen.

Kur deshtën mem lëshue, më quen ma hjekën kryeqin, me rrafi pa mëshirë komandanti i Dubravës, Villastra Petroviqi. Pa vetdije me kanë qitë zhag jashta burgut.

Vjen kryqi i kuq ndërkombëtar, më pan, lajmruen Beogradin, e kërkuen kerrin e ndimes së shpejt. Vjen ambulanca, ma vuen brenda një bocë me gjak, një bocë me ushqim. Drejt në Nish. Në Nish tentuen mem que në spital të Anglis, por nuk mundën të më bindin!

E lajmruen spitalin e Prishtinës me ma qit ambulancën në Merdare. Në Nish mi ndrruen teshat se i kisha me gjak!

Kur mbririmë në Merdare, ken nuk kam njoft!

Me kerr të spitalit më dërguen në Ruhot.

Antarët e familjës nuk i kam njoftë!

Pra me shtatë prill 2001 u lirova dhe u shtrova në spitalin e Pejës.

Si arrijta në spital, vjen Dr.Isa Kaliqani, më pranon dhe merr përgjegjësin për mue.

E lajmrojnë familjen, zonën e tretë të TMK-ës.

Konsultohen për mem bërë operacion. Pas tri dite vjen Isa e me tha: Gani duhët me i que fotografrit tuaja në spital të Italisë. Pas një muaj vjen Isa e më tha Italanët kanë propozue me ta hjek këmbën!

Ju drejtova me këto fjal: ”Jam lodhë, hiqmani këmbën se eci me shtaga”!

Pas ca ditesh në një mbramje erdh Isa e më tha Gani, nesër dojmë me të bërë operacion., por prej shtatë deri në dhjetë centimetra del këmba më e shkurt, ani Isë.

Vjen Isa të nesërmen në mengjez me stafin e vet, vjenë zona e tretë përkatësisht dy mjek nga Shtabi i Përgjithshëm i TMK-ës, e bijnë edhe aparatën.

Me operuen: Këmba mbet shumë shkurt. Isa tha duhet me shkue me dy shtaga. Pa shtaga nuk bënë > Varra kurrë nu mshelët, tana herë ka me të kullue.

Unë si Gani e falënderoj Dr.Isë Kaliqanin, stafin e tij, zonën e tret të TMK-ës.!

Pas një viti nga moskujdesi u rrëzova, m’u këputën venet e dy këmbeve!

Shkova drejt në spital. Më pranoj Dr.Mithat dhe drejt me quen në sallë. Bashkë me Dr.Morinën me operuen, Pas tri dite Mithati më tha: ”Gani apet duhet me të bërë operacion”.



Ani Dr.Mithat.

Pas një viti mu aj këmba dhe Dr.Mithati më beri operacion. I thash, o doktor, hiqmani krejt.

Jo a mendon se jam gjerman?! me ta nue llangentën.

Ani Mithat.

Mu drejtue. Une nuk pritoj me ta berë vizitën në shtëpi.

Gani tash jemi në liri.

-Shokë mjekti je kanë në liri,...Për mue vlla, babë gjatë luftës kur me kan prue sebosllavet këtu, ki rrezikue kokën tande dr.Mithat. Unë nuk kam lan me shkruie sa me ke ndihmue! Për ty me shkruie ditë e natë, me muaj, me dukën shumë pak.

A të kujtohet një mjek kur na shau: mue, ty, Isën, Rrahman Maxharrin, Thoshte: "Peja i ka tre kriminel, ai i njeh më tha: Mithat Jakupin, Isë Kaliqanin e Rrahman Maxharrin!

Nuk bëra atëherë zë! Pas pak i thash: "Janë shumë mjek të mirë"! Ma shau nanën mue dhe tre mjekët-kolegët e vet. Nuk kisha çka me bë.



**Shemsi Alias- Gani Shala dhe Halit Elshani në shtëpinë e Ganiut në Ruhot**

Çel Alia kur ka ndëgjue se jam plagos, menjëherë vjen te unë në spital. Tentuen me shti Çelën me më shti me thanë se unë jam Ganija! Por ai e mbajti fjalën. Pasi më liruen nga burgu rash në spital të Pejës siq thash më lartë. Vjenë në mengjes para vizitës me pa motra Atifete Shala.

I shkuen lotët.

O Gani kam mendue se të kanë mbyet!

Shokë e shoqeve ju kam tregue rastin. Ja plasi vajt përsëri. Pse motër po qanë, a po e shef se jam gjallë!

Më tha vetëm unë e Mithati e dijmë rastin tand. Faliminderes motër, nuk paske harrue!

Në banjë të Pejës dy vjet jam shërue pa kompenzim.

Drejtori Hamdi vet më ka sherue-ndihmue sa ka mujt.

Pas dy vjet pan se sherim nuk ka.

Më than vetëm në spitalin e Shqipërisë ka ilaq.

Menjëherë udhtova për Shqipëri. Pas 20 ditesh edhe ata me thanë nuk ka shërim!?

Tash vazhdimisht bëj kontrollën në Pejë te Dr.Mithat Jakupi.

Të gjithë mjekët dhe motrat që janë kujdesë për mue i falënderoj në emër timin, familjes dhe gjakut të derdhur.

***Gjatë burgut në Gjakovë për mua është kujdes:***

1. Dr.Selajdin Boshnjaku

***Në Pejë***

1. Dr.Mithat Jakupi,

2. Dr.Isa Kaliqani,

3. Enver Muja

4. Dr.Nazmi Morina,

5. Dr.Rrahman Maxharri,

6. Gani Rama,

7. Sali Shala,

8. Sabrie Nazja,

9. Fatime Shala,

10. Atifete Shala,

11. Fatmushi...,

12. Ramiz Baci,

13. Zenun Shatri,

14. Hamdi Blakaj,

15. Ahmet Blakaj,

16. Talat Gjinolli,

17. Imer Qavolli

Dhamët mi patën thye në Beograd!

**Dr.Shefqet Mehmetaj** mbas lirimit ka ardhë te shtëpia ime, më qon në ordinance, mi vnon pa të holla dhëmbët. Ky gjate tanë luftës ju ka ndihmue popullatës, me mjekime, barna etj në Ruhot.

## **Burgu i Dubravës**

Sa i përkët burgut të Dubravës mendoj se ma së miri din me tregue:

1. Hasa Dalloshi-Doganaj,
2. Halil Ademi-Xhurit,
3. Nait Hasani-Prishtinë,
4. Tahir Panxha-Kosuriq i Pejës,
5. Xhelal Canziba-Rahovec

Do të ishte ndoshta...pyetni Reshat Nurbojën dhe Halil Ademin çka ju kanë thënë gjakovarët kur kanë shkue në burgun e Dubravës me ua qel derën. Unë si Gani vetëm mem dvet se nuk japi informata për burgun e Dubravës.

Po ndëgjoj edhe çka nu ka ndodhë në burg!

Këta të lartshënuarit ma së miri dijnë me i përshkrue ato ngjarje, tmerre që kanë ndodhë.

Kur më gjetën kryqi kuq ndërkombetar në Beograd.

Vijnë në shtëpi dhe tregojnë se Shemsia është gjallë!

Menjëherë aksioni i tubimit të hollave.

*Grupi:*

1. Besim Kuqi,
2. Qerim Osmani,
3. Istref Berisha,
4. Jonuz Istrefi

Kërkojnë ndihmë nga fshatrat e Ruhotit, Trestenikut, Lutugllavës, Trubuhovc, Saradran dhe Zabllaq.

Por edhe shumë fshatar e mërgimtar japin deri edhe në 10.000 marka.

Në vitin 2001 në spital të Pejës vijmë ndërkombëtarët:

Herë më merrshin me të mirë me ju tregue çka kam përjetue në burgje, në Beograd, bie fjala. Kam shkue me zor në Beograd. I mbyetshin nga torturat e vinin në mengjes me ju dhënë nënëshkrimin se kanë vdekë vet!

E patën mbyet **Tefik Varoshin**, plak mbi 82 vjeq.

Më kanë marrë në pyetje mbi 100 herë, çka nuk më kanë dvet!

Pse ta kanë ndrrue emrin!

Ju pata thënë shkoni e vetni ata! Popi ju tregon!

### Savrovë

Me Fatmir Kukullari, ushtarë i UÇK-ës, u njoftova në autobus tue shkue për Beograd.

Më pyeti Shemsi ku je varrue?

Në Gjakovë i thash.

Po ti Fatmir?

Jam varrue në Dubravë në mesin e 15 vetave!

Shemsi ti më ndihmon, -ani i thash.

Kur mbrrim në Pozharevac, mbi 22 varre në trup i kishte pasë. Tregonte si e kanë lanë me shaktë të varruar, qyesh Halil Ademi e ka gjetë. Shumë të varruar nuk bëjshin zë!

Kjo ishte jeta në burgje dhe ky ishte psimi i të burgosurëve në Dubravë.

*Filloreta Shala shkruan*

## Unë dhe lotët

Përsëri erdhi pranvera bashkë me cicërimat e zogjëve. Në mengjezin e një prilli kur më doli gjumi aty në dhomën time, isha shtri në shtrtatin tim, i ndëgjova ca cicërima zogjësh dhe një aromë gjelbrimi. Menjëherë me pikën lot nga syet e mij! Thash në vete: Ah sikur t'ishte babi e me I ndëgjue së bashku zogjët tu ja thënë këngës në stinën e pranverës që ka ardhë më gjelbrim. Ah natyrë, natyrë, ke marr krejt pamje tjetert, varri i babës është mbulue nga gjelbrimi, e shtyllat e varrit janë përplot zog duke këndue babin tim.

I thonë zgjohu se pranvera erdhi! Lejleket ikën, erdhën përsëri dallandyshët, erdhën bashkë me fluturat që ta kanë qëndisur lapidarin tënd të artë i cili për jetë e mot ai do të jetojë. Kështu zogjët i këndojuhin babin e unë e mjera thash: *O babë qyesh nuk të kam pran?*

Një ditë pranvere i mblodha ca lulevjollce dhe i mora e i futa në një gotë, me lotët e syeve të mij që unë lutna çdo ditë të kthehët prapë, por kjo është shpresë e kot. I futa ato lulevjollce n'at gotë me lot dhe ja ofrova pranë i thash kur të merr etja lotëtët e mij pi! Kur të duesh thithë aromë të luleve, merri aromën se babi im këtu pran i ki.

U ktheva prap në shtëpi, u futa brenda në dhomën time e pash babin në fotogfafi.

E unë me vrap e morra at fotografi, e përqafova fort me ngrohtësi dhe e mbajta sa kohë në gji. Kur e morra atë fotografi e i mylla sytë, mu duk se po thot babi eja, eja shpirti im, e unë duke veprue drejt tek i hapa syet dhe thash: "Kështu sa herë i ndëgjova cicirimet e zogjëve, mue më dukej se po më mbulon dheu, dheu i zi, sikur



babin tim! Që e mbuloj aq të rinjë, e mue më la me lot në sy!

Ku je babi im ”Unë çdo herë isha e dalluar në shkollë. Unë kur hyesha n’oborr të shkollës, të gjithë më shikonin se si isha veshur, pra kuptohet si isha veshur. Kur hyente mësuesja në klasë, unë ulur në fund të klasës.

Një ditë mësuesi tha se detyrë shtëpie që ta shkrueni një ngjarje që ju nuk e harroni dot.

Unë at ditë kur shkova në shtëpi, e morra një copë letër që të shkruaj, sepse nuk kisha fletore, por, por as ajo letër nuk mi zante fjalët që kisha për ti shkruar për ngjarjen e jetës që më kishte ndodhur kur unë i kisha 11 vjet.

Ja fillova asaj ngjarje të shkruaj, por si duket edhe lapsi im kishte vështirë të shkruaje, as fleta si duket nuk mund t’i përballonte që t’i mbaj ato fjalë aq të hidhura për një fëmijë jetim.

Të nesërmen kur erdhi mësuesi në klasë dhe pyeti a i keni krye detyrat?

Po!

Të gjithë i lexuen ngjarjet e kur erdhi rendi te unë!

Mësuesi më tha eja don që të lexosh, unë i thash mësues nuk kam pas fletore që të shkruaj, por do të tregoj me fjalë dhe ai me tha mirë: Fillova disi t’u tregue se unë nuk kam babë, se më la jetime.

Fillova të qaj dhe kështu ishte jeta e ime e përlotur, e zhgënjyer!

Por prap e shijova lirinë e vendit tim!

### **Pozharevc**

Pasi e kreuva rigjykimin, më dënuen 2 vjet, u ktheva në burg te shokët dhe ju tregova fill për pe.

Ndoshta nuk është e tepert të thëm: shokët që me kanë ndihmue janë:

1. Zeqir Gashi nga Broliqi,
2. Skender Hoxha nga Jasharajt,
3. Ekrem Bajra nga Mitrovica,
4. Fadil Krasniqi nga Gjakova,
5. Rasim Jaha,
6. Shaqë Selmani nga Gllogjani,
7. Rasim Selmani nga Gllogjani,
8. Tahir Panxha nga Kusurriqi

Të gjith këta më këshillonin, se nuk duhet të mërziteni.

Jemi shumë, të jeni shumë të lumtur që shkon në shtëpi. E une ju thojsha qysh do të shkoj une. Çka ju tregoj për shokë, që mi vranë. E une isha i gjallë. Kur të më shofin nuk kam çka të ju them, - po si jo ata e kanë dhënë jetën për liri. Ti Shemsi duhet të shkojsh në shtëpi. Vizitoh lapidarët se tash pranvera ka ardh, dallëndyshet, ..duhet me qenë krenar si pjesë të trupit që ke lanë.

### Centrallni zatfor Beograd

Gjatë dymbdhjeëe muaj e gjysëm isha në vetmi. Kanë ardh edhe kanë tentuar me të mirë, më thojshin me na falë njërën veshkë, na të shërojmë. Me thojshin: ‘kush nuk e din për këtë, nuk kam guxuar as shokëve me ju tregue! Pas 8 ditësh kanë filluar të me rrafin rresht 17 ditë pa ndërpre deri sa e kam pranuar kërkesen e tyre. Pra, nga zori, nga torturat që mi banin. Më muarën e më quan në spital. Aty e pashë një grua të cilën e quajshin Sonja Markoviq. Komandirat i than që “ky don me ja dhanë burrit tënd veshkën”! Ajo nuk bëri zë. Tu desht mem que ne sale, më pyeti qajo grua:

“Nga jeni ju lutem?

Unë jam nga Kosova.

A ke qenë ti ushtarë i ushtrisë çlirimtare, UÇKA?

Po bërtita sa muejta, dhe poashtu ajo tha se nuk e pranoj kurrë me ta marrë veshken tënde!

Shanë komandirat, mjekët Milloshin edhe burrin e vetë.

Mu kthye e mu falënderua ajo grua.

Une ju drejtova dhe i tregova: ”se 17 ditë më kanë rrahur për çdo natë për të pranuar që tua jap veshkën dhe nga torturat dhe zori e kam pranua.

Kështu ajo gruaja më tregoj se si quhet.

Sonja Markoviq.

Kështu me 2 gusht të vitit 1999 pshtova pa ma marrë veshkën, nga se isha ushtar i UÇK-ës!

## Dubravë

**Data 19 maj 1999**

Pse nuk e marrin Hasa Dalloshin ne pyetje për Burgun e Dubravës?

- Kush i thej dyert e na shpëtoj nga tymi e flaka. Përveq tre trimav: Hasan Dalloshi, Naim Kurmehaj dhe Ismet Musa.

-Si Hasan Dalloshi i shkeu qarshafat dhe ua lidhte varret të plagosurve!?

- Pyetni Halil Ademin e Reshat Nurbojën çka i kanë thanë të burgosuit gjakovar kur kanë shkuar me jau thyeqelur derën me i shpëtue nga tymi dhe flaka gjatë bombardimit.

**- Ikni se ju jeni UÇKISTA!**

- Komandirat i ranë! E rrahën Halil Ademin!

Në Burgun e Dubravës në Pavionin C me 22 maj 1999 u njohtova mirë me Hasan Dalloshin dhe me Dervish Sylen. Për çudi ndoshta edhe marri nuk del askush me pyet prej të burgosurve për hallin tim. Përveq Dervish Syles, i cili është i vetmi person në mesin e 1200 të burgosurve që ju drejtua shkive, unë jam UÇKist.

Rrnoft Ramush Haradinaj.

- Posht Shkiet!

-Hakun do ma merr Ramushi!

-Amanet Hasan e Shemsi lajmroni ne shtëpi thjueni nanës e shoqës rujmni fëmijët kujdesuni për ta.

- Dihet fati ku shkau me thikë ja pren kryet.

## **Përfundim**



Ky ditar ka 91 njisi.

Është shtyp në kompjuter që kanë dal 18 faqe.

Ky ditar është më rëndësi cili duhet të ruhet në institucionët tona sepse ka vlera të mëdha, ka një histori se çfarë peripetish dhe çfarë represioni e gjenocidi ka ushtruar regjimi i satrapit të Ballkanit, Millosheviqi.

Ky ditar është i rrallë dhe duhet të ekspozohet në Arhivin e Republikës së Kosovës.

Gjeneratat që vijnë pasë nesh do ta shfrytëzojnë dhe do e kuptojnë dhe do besojnë se çfarë ka hjek populli ynë, e sidomos UÇK-istat, e cila i dha botës edhe një vlerë markante në historinë e rezistencave, aspiratave për liri.

Kjo gueril është vlerësue ndërkombëtarisht: "Si guerila më e sukseshme gjerë më tani në botë".

Duke lexuar këtë ditar çdo njeri normal do të befasohej se çka mund të bëjnë urrejtja e një kombi ndaj tjetrit. Kjo i ka rrënjët nga regjimet fashiste!

Fatkeqësisht populli ynë liridashës e përjetoj pothuajse një shekull!

Le t'u jetë gjeneratave t'ardhshme kjo si dëshmi për ta desht njeri tjetrin, për t'a rrujt e kultivue shtetin tone i cili me shumë mund e sakrificat u realizue.

Bruksel, 01.10.08

**Halit Elshani**

## **Halit Xh. Elshani**

Ka lindur më 01.01.1944 në Dasam (ish Staradran) të Komunës së Burimit (ish Istog). Rrjedh prej një familje atdhetare e cila ka qenë e anatemuar - sidomos në kohën e komunizmit etatist sërbo-jugosllav, e persekutuar dhe djegur më 1918, 1924 si dhe gjatë luftës së fundit më 1999. Meq rast janë pushkatue dhjetë anëtar të familjes! Shkollën fillore katër klasëshe e ka kryer në vendlindje, për të vazhduar më pastaj në Gurakoc. Studimet e larta për matematikë dhe ekonomi i kreu në Universitetin e Prishtinës. Fillimisht ka punuar si arsimtar në Kijevë, vitet 1964/65, pastaj si mësues në Staradran për të vazhduar si mësimdhënës i matematikës në shumë shkolla fillore dhe të mesme në trojet shqiptare, në Kosovë dhe Medvegjë, detyrë këtë të shenjtë që e ka vazhduar gjerë në fillimin e luftës heroike të UÇK-së, përkatësisht gjerë me dëbimin e dhunshëm nga ana e regjimit fashist sërbo-jugosllav.

Gjatë periudhës së viteve 1964-1999 ishte mentor për lëndën e metodikës së matematikës për studentët e këtij grupi të SHLP-ës të Universitetit të Prishtinës, bashkëpunëtor revistash profesionale, gazetash ditore dhe periodike, recenzent i disa teksteve nga lëmia e



matematikës, autor i disa punimeve metodikje-pedagogjike në fushën profesionale.

Ishte bashkëthemelues i shkollës tetëvjeçare në vendlindje, i gjimnazit “Hivzi Sylejmani” në Fushë-Kosovë, i gjimnazit real në Lypjan, i gjimnazit në Vushtrri, i mësimit të orientuar në Medvegjë, i sindikatës SBASHK-u të BSP të Kosovës. Ishte sekretar i Shoqatës Humanitare “Nëna Tereze” - i nënëdegëve në gjashtëmdhjetë lokalitete të komunës së Prishtinës, i degës në Drelaj të Rugovës, i Degës në Preshevë, i LSHB-ës në Bruksel, i Degës së Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës për Shtetet e Beneluksit, i degës se kësaj partie në Antwerpen të Belgjikës, i Shoqatës: ”Miqte e TMK-së në Bruksel përkatësisht i Shoqatave të dala nga Lufta. Ishte pjesëmarrës në demonstratat e studentëve më 1968 në Prishtinë dhe i burgosur në Pejë. Ka qenë bashkëorganizues i shumë manifestieve në diasporë, i grevës dhjetëditëshe në Bruksel për lirim e të burgosurve, i përvjetorëve të atdhetarëve Enver Hadri, Luan dhe Shkelzën Haradinajt, i demonstratave para Parlamentit Evropian në Bruksel, për kidnapimin, për lirim e të burgosurve dhe të pa gjeturve nga ana e Serbisë, i demonstratave në Hagë për lirim e Fatmir Limës. Ishte pjesëmarrës në protestën në Bruksel, Holandë për gjenocidin grek ndaj Çamëve.

Ka marrë pjesë në senzibilizimin e shkollës shqipe në Belgjikë.

Në aktivitetet sportive dhe humanitare ka qenë sekretar i klubit basketbollist “Elektrokosova“, sekretar i Shoqatës Bëmirëse „Nëna Tereze“ - dega Qyteti i Vjetër në Prishtinë, sekretar i LSHB-ës në Bruksel, përfaqësues-sekretar i klubit shqiptaro-belg “Vokshi“ në Skarberg të Belgjikës. Bëri mbledhjen-pregaditjen për botim të “Monografisë së shkollës Naim Frashëri“ (1964-1965), në Prishtinë. Tash është nënkryetar i Shoqatës „Miqte e TMK“-së në Bruksel. Autor i romanit: ”Çeta e Brukselit“; Enver Hadri; ”Kosova është gjaku ynë qe nuk falet“! 2007, koautor i librit; ”E djathta shqiptare në mbrojtje të Shqipërisë Etnike(nr.5,6), autor i librit “Çeta e Gostivarit” (Plaku i maleve Gjelë Gjelili Kalishti nga Gostivari), 2009, i Monografisë së familjes Elshani nga Dasami (ish Staradrani 2016, “Çeta e Brukselit 2” (Morfologjia e një fushate), 2016, Shoqata Humanitare bamiëse-Nëna Tereze-Dega Qyteti i vjetër në Prishtinë, 2016 ”.

Ka në dorëshkrim: Libri për Drinin: ”Një jetë një vdekje”, Librin për arsimtarin Taib Sylejmani, Monografinë për “Islihatit”, Gjeneaologjia e trungut të familjes Elshani, Lenagrafik, Prishtinë, 2016.

Për veprimtarinë e ndritshme të tij është nderuar me mirënjohje nga: Shkolla fillore “Naim Frashëri” – Prishtinë, Shoqata Bëmirëse “Nëna Terezë” - Prishtinë, Shoqata Humanitare “Merahmet” – Sarajevë, Ministria e Arsimit të Republikës së Kosovës – Prishtinë, nga Shkolla e Lartë Pedagogjike-të Universitetit të Prishtinës, nga LASH-i, siq thuhet: ”Për kontributin e dhënë për arsim dhe edukim të brezave të rinjë në shkollën shqipe”, në Mbreterinë e Belgjikës. Nga senatori i përjetshëm, miku i shqiptareve e posaqërisht i Heroit Enver Hadrit dhe ish presidentit Ibrahim Rugova Z. Vili Kujpers, nga shkolla fillore e mesme e ultë ”Enver Hadri”-KK Vushtrri, nga “RKSHK” e Kosovës “Enver Hadri” me seli në Bruksel dhe nga Rinia e Budakovës: ”Tre korriku” -KK-Suharekë. Është anëtar i Lidhjes së shkrimtarëve të Kastriotit, i kësaj Lidhje në Belgjikë dhe i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe artistëve në Mërgatë.

Mirënjohje z.Halit Elshani nga Ministria e Diasporës për pjesmarrje në takimet tradicionale të krijuesve nga mërgata. Pjesëmarrës në Samitin e parë të diasporës në Tiranë, organizue nga Ministria e Diasporës përkatësisht nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë(18-19 nëntor 2016).

Aktualisht është nënkryetar i Klubi i Boksit «Prishtina» në Prishtinë.

Përmbajtja:

5 – Prolog nga autori